

---

## 3 NDËRFAQJA E PËRDORUESIT

Në këtë kapitull janë përshkruar pjesët e ndërfaqes së përdoruesit të programit COBISS3:

- shfletuesi, i cili prezanton dritaren bazë të ndërfaqes së përdoruesit dhe mundëson përzgjedhjen e moduleve dhe klasave, paraqitjen dhe kontrollimin e objekteve, lëvizjen midis tyre, ekzekutimin e metodave të përgjithshme tek klasat dhe objektet, si dhe metodat që mundësojnë zhvillimin e procesit të punës
- dritarja për kërkim, e cila mundëson kërkimin e objekteve të klasës së përzgjedhur
- redaktuesi, i cili mundëson shënimin e të dhënave dhe ndryshimin e vlerave të attributeve të objektit të përzgjedhur dhe objekteve të përfshira, përcaktimin e objekteve të lidhura dhe kontrollimin e objekteve
- paraqitësi, i cili mundëson paraqitjen e vetive të objektit të përzgjedhur, objekteve të lidhura me të dhe objekteve të përfshira

Për zhvillimin e procedurave të përpunimit të burimeve bibliografike dhe procedurave të punës me regjistrimet e njësuara, në vend të redaktuesit përdoret ndërfaqja për katalogim, i cila është e përshkruar në manualin *COBISS3/Katalogimi* (shih kap. 3).

Nënkapitujt:

- Shfletuesi
- Dritarja për kërkim
- Redaktuesi
- Paraqitësi